Duke u mbështetur në nenin 51 paragrafi 2 dhe 3 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 30 dhe 35 të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe dispozitave të Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, nenit 4, 5 dhe 11 deri 21, të Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve,
me kërkesën e Degës Nisma Socialdemokrate ne Klinë, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-te të rregullt të radhës për vitin 2018, të mbajtur, më 21.09.2018, mori këtë:

V E N D I M
Për
Ndryshim të Vendimit për Themelimin e Komiteteve Tjera
Zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Pronë
me anëtar të ri (neni 51 pika 51.2 dhe 51.3 të LVL)

I

Miratohet vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Pronësi **Liridon Morina-nga Nisma Socialdemokrate –Dega në Klinë (në largim)** me **anëtaren Alberina Foniqi Bojaj-po ashtu nga Nisma Socialdemokrate Dega në Klinë (në ardhje).**

II

Ky vendim është pjesë e vendimit Për themelimin e Komiteteve Tjera të miratuar me dt. 28.02.2018, 01nr.06-1361/18 konform pikës 1 të këtij vendimi.

III

Vendimi është i plotfuqishëm me miratim nga Kuvendi dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen e Komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari, Komiteti për Arsim, Kulture Rini dhe Sport, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 060 – 6298 **2018**
Klinë, me 26.09 **2018**

K r y e s u e s i,
Fadil Gashi